



**VENDIM**

**Nr.46, Datë 16.06.2014**

**PËR  
AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË ENTIT RREGULLATOR TË  
ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, si dhe të pikës 4 të nenit 7 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.06.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dërguar me shkresën nr.3704, datë 13.6.2014 “ Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqerine CEZ a.s”,

**Vendosi :**

1. Autorizohet Z. Petrit Ahmeti, kryetar i Entit Rregullator të Energjisë, që të marrë pjesë në procesin e finalizimit të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s;
2. Në rast të arritjes së një marrëveshje, autorizohet Z. Ahmeti, që të nënshkruajë marrëveshjen dhe cdo instrument që i bashkëlidhet asaj, në emër të Entit Rregullator të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.